



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 78 Prot.

Tiranë, më 24.1.2024

URDHËR
Nr. 11, datë 24.1.2024

***PËR FILLIMIN E MBIKËQYRJES SË ORIENTUAR PËR NJOHJEN E
SITUATËS NË LIDHJE ME NUMRIN E INSTITUCIONEVE QË BËJNË PJESË
NË SHËRBIMIN CIVIL, NUMRIN E POZICIONEVE TË PUNËS PJESË E
SHËRBIMIT CIVIL, NUMRIN E NËPUNËSVE CIVILË TË EMËRUAR NË KËTO
POZICIONE DHE TË DHËNA TË TJERA STATISTIKORE***

Në takimin e përbashkët me ekspertë të Bashkimit Evropian në kuadër të raportit të përputhshmërisë (*compliance report*) për mirëqeverisjen dhe reformën në administratën publike, të zhvilluar në muajin mars të vitit 2023, është evidentuar fakti se nuk ekziston ende një informacion i plotë dhe i saktë për numrin e institucioneve që bëjnë pjesë në shërbimin civil, numrin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, numrin e nëpunësve civilë dhe të dhëna të tjera që lidhen me to. Qartësimi i kësaj situatë do të shërbente edhe për të përcaktuar qartë subjektet që mund të përfshihen në procese mbikëqyrjeje, në kushtet kur ky informacion nuk mund të gjenerohet ende në mënyrë të plotë nga Regjistri Qendror i Personelit, i administruar nga DAP.

Për këtë arsye,

në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, miratuar me Vendimin nr.1, datë 11.01.2024, të Komisionerit, Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit” miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, ndryshuar me vendimin nr.158, datë 30.12.2022, të Komisionerit,

V E N D O S A:

1. Fillimin e mbikëqyrjes së orientuar për njohjen e situatës në lidhje me numrin e institucioneve që bëjnë pjesë në shërbimin civil, numrin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, numrin e nëpunësve civilë të emëruar në këto pozicione dhe të dhëna të tjera statistikore.

1. Ngritjen e grupit të punës me këtë përbërje:

i. Enkelejda Hebibasi	Drejtor i Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese
ii. Stela Ndoka	Inspektor
iii. Besjana Zyli	Inspektor
iv. Elvis Qerimaj	Inspektor
v. Erjon Mata	Inspektor
vi. Nean Muçaj	Inspektor

2. Ky proces do të realizohet nëpërmjet komunikimit zyrtar (*me shkresë dhe/ose e-mail*) dhe/ose nëpërmjet verifikimit në subjekt, në varësi të problematikave eventuale që mund të shfaqen gjatë realizimit të tij.
3. Në përfundim të procesit të mbikëqyrjes, do të hartohen relacionet përkatëse, ku do të evidentohen në mënyrë të detajuar të dhënat e grumbulluara, si dhe do të bëhen përgjithësimet eventuale, duke evidentuar edhe statistika me interes lidhur me aspektet e mbikëqyrjes. Ky proces të mbyllet me një raport vlerësimi për situatën.
4. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi, Drejtorja e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe struktura përgjegjëse për realizimin e këtij procesi, Drejtorja e Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit.
5. Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të sigurojë mbështetjen e grupit të punës, me logjistikën e nevojshme, për vijimin normal të procesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha